

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7119
E premte, 16 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

“Shpallim Kosovën shtet të pavarur...”, rrugët mbushen me billborde të Thaçit për 16-vjetorin e pavarësisë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORI I SHBA-SË NË PRISHTINË FLET PËR RAPORTET ME KOSOVËN PAS VENDIMIT PËR DINARIN SERB

FAQE 4-5

SHBA-ja KONFIRMON SE JANË 'LËNDUAR' RAPORTET ME KOSOVËN



Ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka deklaruar se vendimi i autoriteteve të Kosovës për ndalimin e dinarit serb ka ndikuar në cilësinë e raporteve në mes të dy shteteve. Në një konferencë për medie ai ka thënë se deklaratat e zyrtarëve amerikanë kanë qenë

vazhdimisht të qarta se Kosova duhet ta shtyjë vendimin e zbatimit të rregullores së BQK-së. Hovenieri ka theksuar se ndihet i shqetësuar nga deklaratat publike të kryeministrit Kurti dhe zyrtarëve të tjerë të pushtetit pas intervistës së O'Brienit, të cilët pretenduan se partneriteti ShBA -

Kosovë nuk është prekur dhe mund të mos preket nga kjo situatë, duke shtuar se "duhet të jem i qartë se kjo nuk është aspak e vërtetë. Nuk është kështu". Në këtë drejtim ai ka thënë se është "gjë e rrallë" që Kosova të kritikohet nga ShBA-ja në Këshillin e Sigurimit të OKB-së

BLINKENI SHPREH MIRËNJOHJE PËR PARTNERITETIN ME SHQIPËRINË

F.7

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, të enjten ka vizituar Shqipërinë. Me këtë rast, ai ka shprehur mirënjohje për partneritetin e ShBA-së me shtetin shqiptar. Blinkeni gjatë qëndrimit në Tiranë ka lavdëruar edhe Edi Ramën, duke e quajtur lider të shquar dhe kryeministër shumë të mirë



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



POZITA DHE OPOZITA ME DEKLARATA KONTRADIKTORE PËR RAPORTIMIN E BISLIMIT F.3

ZYRTARISHT KEHUE S'ËSHTË MË AVOKAT I THAÇIT F.6

MUNGESA E LISTËS SERBE LË PEZULL VOTIMIN E NDRYSHIMEVE KUSHTETUESE PËR VETINGUN F.6

EKONOMI



AVOKATI I POPULLIT I DREJTOHET KUSHTETUESES, KËRKON LARGIMIN E "15-VJETËSHIT" NGA LIGJI PËR SKEMAT PENSIONALE F.8

ODA AMERIKANE PROPOZON ALTERNATIVA PËR TRANSAKSIONET ME DINARIN SERB F.8

SPORT



ELSHANI: INVESTOVA NË FUTBOLL E NUK PËRFITOVA, MIRËPËRES NISMAT PËR RITHEMELIMIN E KF BESA F.10

Komiteti Ekonomik dhe Social bëhet institucioni i parë i BE-së që pranon vendet kandidate

BRUKSEL, 15 SHKURT - Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (EESC) është bërë institucioni i parë i Bashkimit Evropian (BE) që ka pranuar anëtarë nga vendet kandidate. Anëtarët e rinj janë emëruar dhe më 15 shkurt kanë marrë pjesë për herë të parë në një seancë plenare të këtij komiteti.

Të pranishëm në ceremoninë e kësaj nisme në Bruksel, përveç kryetarit të EESC-së, Oliver Ropke, ishte edhe zëvendës-presidentja e Komisionit Evropian, Vera Jourova, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe ai i Malit të Zi, Millojko Spajiq, që vijnë nga dy shtetet kandidate për anëtarësim në BE.

EESC-ja merret me çështje sociale dhe ekonomike dhe në këtë komitet marrin pjesë përfaqësuesit e shoqërisë civile, sindikatave, punëdhënësve dhe sektorëve të ndryshëm të industrisë. Në BE ky institucion ka rolin këshillëdhënës.

Anëtarët e këtij komiteti, që vijnë nga vendet kandidate, do të marrin pjesë aktive në punën e EESC-së dhe do të jenë të barabartë me kolegët e tyre nga shtetet e BE-së. Megjithatë, ata nuk do ta kenë të drejtën e votës. Në këtë komitet janë pranuar anëtarë nga nëntë shtete kandidate dhe jashtë ka mbetur Kosova, shtet i përfshirë në procesin e zgjerimit, por që është i vetmi në Ballkanin Perëndimor që formalisht nuk ka statusin e shtetit kandidat për anëtarësim në BE.

Sipas presidentit të EESC-së, Oliver Ropke, kusht formal për t'u përfshirë në këtë komitet është pasja e statusit të vendit kandidat, që Kosova nuk e ka. Ky komitet ka pranuar si anëtar Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Gjeorgjinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë, Serbinë, Turqinë dhe Ukrainën. Që të gjitha këto shtete formalisht janë vende kandidate për anëtarësim në bllokun



evropian.

Ropke ka thënë se kjo nismë shënon një hap të rëndësishëm drejt integritimit gradual të shteteve kandidate, para se ato formalisht të anëtarësohen në BE. Ai tha se pret që kolegët nga këto shtete të sjellin përvojë të dobishme në punën e institucionit që ai udhëheq.

Komisionarja evropiane Vera Jourova ka thënë se zgjerimi i BE-

së është interes i përbashkët, rrugë e dyanshme që sjell dobi edhe për vendet kandidate, edhe për BE-në. Ajo bëri thirrje që vendet kandidate të fokusohen në vlerat e demokracisë dhe të lëvizin drejt BE-së duke i respektuar vlerat e përbashkëta, sidomos sundimin e ligjit dhe lirinë e medieve. Ka pasur më shumë se 600 kandidatë nga vendet kandidate për t'u emëruar

në këtë komitet.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe ai i Malit të Zi, Millojko Spajiq, shprehën gatishmërinë që vendet e tyre të punojnë drejt integritimit gradual në BE jo si zëvendësim për anëtarësim të plotë, por vetëm si rrugë drejt anëtarësimit formal.

Rama ka bërë thirrje që shembulli i EESC-së të ndiqet edhe nga institucionet e tjera të BE-së, përkatesisht nga Parlamenti Evropian, Komisioni dhe Këshilli. Një gjë e tillë, sipas kryeministrit shqiptar, do të bënte që njerëzit në Ballkanin Perëndimor të shohin se integrimi në BE është real dhe një gjë e tillë do ta evitonte hyrjen në cikle të qëllimeve të mira, por që nuk prodhojnë rezultate konkrete.

Rama, duke përmendur ndikimin që ka pasur agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës në rritjen e mbështetjes për procesin e zgjerimit, tha se nuk duhet pritur ndonjë agresion tjetër për të lëvizur përpara në këtë proces.

Erdogani: Turqia e gatshme të punojë me Egjiptin për rindërtimin e Gazës

KAJRO, 15 SHKURT - Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, ka thënë se Turqia është e gatshme për bashkëpunim me Egjiptin për ta rindërtuar Rripin e Gazës.

Ai këto komente i ka bërë gjatë vizitës së tij të parë në Egjipt prej vitit 2012.

Erdogani dhe homologu i vet egjiptian Abdel Fattah al-Sisi kanë folur në një konferencë të përbashkët në Kajro pas bisedimeve dypalëshe, duke e ndërmarrë një hap të madh drejt rindërtimit të marrëdhënieve mes dy fuqive rajonale.

Erdogani ka thënë se tragjedia humanitare në Gazë ishte në krye të agjendës së bisedimeve mes tyre. "Ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me vëllezërit



tanë egjiptianë për t'i dhënë fund gjakderdhjes në Gazë", ka thënë Erdogani, duke shtuar se Turqia është e vendosur për t'i shtuar bisedimet me Egjiptin në të gjitha nivelet, në mënyrë që të vendosë

paqe dhe stabilitet në rajon. Erdogani është zotuar për ta rritur tregtinë me Egjiptin në 15 miliardë dollarë në afat të shkurtër kohor, duke nënvizuar se dy vendet po e shqyrtojnë bashkëpunimin në

energji dhe mbrojtje.

Marrëdhëniet në mes të Ankarasë dhe Kajros janë prishur në vitin 2013, pasi Sisi, atëherë shef i ushtrisë, e kishte udhëhequr rrëzimin e Mohamed Mursit të Vëllazërisë Myslimane, i cili ishte aleat i Turqisë që ishte bërë presidenti i parë që ishte zgjedhur në mënyrë demokratike në Egjipt një vit më herët.

Por, vitin e kaluar këto dy vende u pajtuan për emërimin e ambasadorëve dhe këtë muaj Turqia tha se do t'i japë Egjiptit dronë luftarakë.

Erdogani ka kërkuar t'i ulë tensionet me Egjiptin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabinë Saudite dhe Izraelin prej vitit 2021, por prej tetorit të kaluar ai e ka

kritikuar publikisht kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu për shkak të luftës shkatërruese të Izraelit kundër Hamasit në Rripin e Gazës.

Egjipti, Izraeli, Katari dhe Shtetet e Bashkuara mbajtën bisedime jobindëse të martën në kërkim të një marrëveshjeje për armëpushim në Gazë.

Kajro e ka bërë të qartë se nuk do të lejojë eksod të palestinezëve nga Gaza brenda tokës egjiptiane. Mursi ka vdekur në burg në Egjipt më 2019. Anëtarët e tjerë të lartë të Vëllazërisë Myslimane ose ndodhen në burg në Egjipt, ose kanë ikur jashtë vendit, përfshirë në Turqi. Vëllazëria Myslimane vazhdon të jetë e jashtëligjshme në Egjipt.

Katër të vdekur nga zjarri në Tivar të Malit të Zi

TIVAR, 15 SHKURT - Tre të mitur dhe një person i moshës madhore kanë vdekur nga zjarri që shpërtheu mëngjesin e 15 shkurtit në një vendbanim rreth orës katër në një lagje të banuar me romë në Tivar në Mal të Zi.

Zjarri, që ka shpërthyer rreth orës 04:00, ka përfshirë disa objekte dhe më pas është njoftuar zjarrfikësja.

Siç ka thënë prokurorja Mirjana Tankosiq Vuçiniq për "Radion Evropa e Lirë", katër trupat e

pajetë janë gjetur në vendngjarje. "Kemi gjetur katër baraka të djegura dhe katër trupa të djegur në to. Shkaku i zjarrit do të dihet pas vlerësimit të ekspertëve", ka thënë ajo.

Zjarri ka përfshirë një lagje të improvizuar ku jetojnë kryesisht romë. Këshilli i Romëve në Mal të Zi ka thënë se kjo tragjedi tregon se sa është e nevojshme shpërngulja e familjeve romë nga lagje të tilla. "Fakti që shumë familje detyrohen të jetojnë në baraka

të parafabrikuara, pa kushte dhe siguri adekuate, është një problem serioz social. Pa mbështetjen dhe masat e duhura mbrojtëse, këto familje janë të ekspozuara ndaj një rreziku më të madh të aksidenteve siç është ky zjarr", ka thënë këshilli.

Këshilli i Romëve u ka bërë thirrje autoriteteve shtetërore t'i përmirësojnë kushtet e banimit për popullatën romë në Tivar dhe në mbarë Malin e Zi.



Pozita dhe opozita me deklaratat kontradiktore për raportimin e Bislimit

PRISHTINË, 15 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka raportuar të enjten prapa dyerve të mbyllura në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë për çështjen e dialogut me Serbinë. Deputetet Arbëreshë Kryeziu-Hyseni dhe Ariana Musliu-Shoshi kanë dalë me deklaratat kontradiktore lidhur me raportimin e Bislimit në këtë komision.

Kryetarja e këtij komisioni nga radhët e Vetëvendosjes, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, ka thënë se raportimi është mbajtur me dyer të mbyllura për shkak të shpalosjes së dokumenteve konfidenciale. Ajo ka thënë se deputetët kanë marrë informacione që kanë qenë të nevojshme sidomos për deputetët e opozitës, të cilët i ka akuzuar për deklarime të pavërteta për procesin e dialogut. "Vetë fakti që kemi vendosur ta mbajmë një takim të mbyllur është se zëvendëskryeministri na ka paralajmëruar se do të ndajë me ne disa dokumente të cilat janë

konfidenciale dhe nuk preferohet të ndahen me opinionin për shkak se procesi është shumë fragil në fazën që është. Kemi folur për procesin e dialogut në faza të ndryshme, por fokusi ka qenë te çështja e Banjskës dhe kemi folur shumë edhe për atë se çfarë pritet të ndodhë në procesin e dialogut tash e tutje. Kemi marrë informacione që besoj se kanë qenë shumë të nevojshme të ndahen në veçanti për deputetët e opozitës të cilët herë pas here i shohim që nxjerrin në opinionin publik informacione që janë krejtësisht të pavërteta", ka theksuar Kryeziu-Hyseni.

Ky raportim, sipas saj, "ka ndihmuar që të paktën këtë të mos e bëjnë tash e tutje".

Një gjë e tillë është mohuar nga deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi. Ajo e ka akuzuar zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi për sulm personal. "Mora një sulm personal, i cili nuk është aspak për t'u vlerësuar. Por nëse zëvendëskryeministri e vlerëson, atëherë ato sulme personale



mund edhe t'i bëj publike, sepse vlerësoj se jam faqebardhë në çdo aspekt. Sulmet ishin të nivelit profesor-student, gjoja se jam kapur në plagjiaturë në kohën sa kam qenë studente në AUK, por kjo nuk qëndron pasi kam qenë studente me 'A'-ja dhe kam qenë bursiste. Prandaj, të gjitha këto janë lehtë të qasshme dhe më vjen keq që në nivelin akademik dhe atë që përfaqëson sot, kemi ardhur në pikën ku në vend se të raportojë për atë çka po ndodh dhe rrugën që po ndjek në dialog, shteti ynë në kohën kur nuk e kemi asnjë

aleat të vetëm i cili sot na përkrah në këtë drejtim, lëshohet në një nivel kaq të ulët personal me mua dhe deputetët e tjerë", ka thënë Musliu-Shoshi, raporton "Kosovapress"

Musliu-Shoshi para gazetarëve ka thënë se nuk ka pasur asnjë dokument konfidencial që është shfaqur në komision, i cili ishte i mbyllur për medie. "Jemi gjithmonë transparentë sepse vlerësoj se dialogu ka njëfarë mase të konfidencialitetit, por disa gjëra kryesore duhet të dihen nga ju si medie. Në këtë mbledhje nuk pati

as dhe një informatë të vetme të cilën e konsiderojmë konfidenciale. Krejt ajo çka provon pushteti të bëjë është të ngrehë drama në publik se, gjoja, po flitet diçka konfidenciale. Nuk pat asgjë më shumë se ajo çfarë keni parë dhe dëgjuar nga Bislimi. Ajo çfarë kërkova ishte të na tregojë nëse ShBA-ja dhe BE-ja nuk janë partnerë me të cilët bashkëpunojmë, nëse Borrelli e Laçaku nuk janë kredibilë në përfaqësim. Atëherë në çfarë rruge po shkojmë, kush janë partnerët tanë me të cilët duhet të ecim përpara? Pse çështjet e brendshme të Republikës së Kosovës duhet të shndërrohen në instrumente për t'u diskutuar në organizata ndërkombëtare, siç ishte ajo në Këshillin e Sigurimit. Çfarë është duke munguar në këtë linjë të komunikimit me aleatët tanë ndërkombëtarë?", ka thënë Musliu-Shoshi.

Lidhur me këtë raportim nuk është deklaruar zëvendëskryeministri Besnik Bislimi.

Zyrtarisht Kehoe s'është më avokat i Thaçit

PRISHTINË, 15 SHKURT - Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë njoftuar se Gregory Kehoe, avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi është larguar nga ekipi mbrojtës i ish-presidentit të Kosovës i cili po mbahet në paraburgim, i akuzuar për krime lufte. "Trupi Gjyqësor në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerët miratoi tërheqjen e Gregori Kihou si kryembrojtës i Hashim Thaçit. Ky vendim hyn në fuqi kur administratorja cakton bashkëmbrojtësin e ri. Duke marrë parasysh se Thaçi dhe Lluka Mishetiç (aktualisht një nga bashkëmbrojtësit e Thaçit) u pajtuan që Mishetiçi ta zëvendësojë Kihoun", thuhet në njoftim.



Sipas njoftimit, trupi gjyqësor vuri në dukje se administratorja mund të vendosë ta udhëzojë Kihoun që të vazhdojë të veprojë ose ta ndihmojë mbrojtësin zëvendësues për një periudhë prej 45-ditësh,

por duke marrë parasysh se mbrojtësi i ri nuk është caktuar ende dhe administratorja nuk ka lëshuar këto udhëzime për Kihoun, ndërsa trupi gjyqësor konstatoi se kërkesa është e

parakohshme në këtë fazë dhe e hodhi poshtë.

Po ashtu, në njoftim thuhet se trupi gjyqësor miratoi tërheqjen e bashkëmbrojtësit të Thaçit, Xhoxhë Rider, ndërsa udhëzoi administratoren që të marrë vendim në lidhje me kërkesën për tërheqjen e tre ndihmësve juridikë dhe të pesë ndihmësve administrativë të ekipit.

Gregory Kehoe dhe Joe Reeder, avokatët e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, u tërhoqën nga ekipi i mbrojtjes për shkak të mosrealizimit të pagesave, nuk janë paguar ngase ata dhe kompania "Greenberg Legal Associates" nuk kanë pasur asnjëherë marrëveshje me

Qeverinë e Kosovës.

Në fund të muajit janar Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet një komunikate për shtyp të martën, njoftoi se është përgjegjëse vetëm për pagesën ndaj avokatit kroat Luka Mishetiç dhe jo ndaj avokatëve të tjerë të angazhuar në mënyrë private nga ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) që po mbahen në paraburgim.

MD-ja deklaroi se që nga viti 2020 mbrojtja juridike e ish-presidentit Thaçi është paguar mbi tre milionë e gjysmë nga buxheti i shtetit. Vetëm për vitin 2023 ekzekutivi i Kosovës realizoi pagesa për mbrojtjen e Thaçit në Hagë në shumën prej 1 milion e 371 mijë e 800 eurove.

"Shpallim Kosovën shtet të pavarur...", rrugët mbushen me billboardet e Thaçit për 16-vjetorin e pavarësisë

Prishtinë, 15 shkurt - Republika e Kosovës nesër (e shtunë) shënon 16-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. Në vigjilje të kësaj feste, rrugët e Kosovës të enjten janë mbushur me billboardet e ish-presidentit Hashim Thaçi, i cili si kryeministër e kishte lexuar Deklaratën e Pavarësisë më 17 shkurt 2008, me të cilën Kosova ishte shpallur shtet i pavarur, sovran dhe demokratik.

Billborde me Thaçin në prag të shënimit të gjashtëmbëdhjetëvjetorit të pavarësisë janë

parë në Veternik, afër lagjes "Priam", në rrugën e aeroportit "Adem Jashari", në fshatin Sllatin, Harilaq etj.

Ky është përvjetori i katërt që Hashim Thaçi si figurë kryesore e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës po e pret në paraburgim në Hagë së bashku me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin dhe bashkëluftëtarë të tjerë, ndërkohë që procesi gjyqësor po vazhdon të jetë shumë i ngadaltë, me seanca të mbyllura dhe aspak transparent.





AMBASADORI I SHBA-SË NË PRISHTINË FLET PËR RAPORTET ME KOSOVËN PAS VENDIMIT PËR DINARIN SERB

ShBA-ja konfirmon se janë 'lënduar' raportet me Kosovën

Ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka deklaruar se vendimi i autoriteteve të Kosovës për ndalimin e dinarit serb ka ndikuar në cilësinë e raporteve në mes të dy shteteve. Në një konferencë për medie ai ka thënë se deklaratat e zyrtarëve amerikanë kanë qenë vazhdimisht të qarta se Kosova duhet ta shtyjë vendimin e zbatimit të rregullores së BQK-së. Hovenieri ka theksuar se ndihet i shqetësuar nga deklaratat publike të kryeministrit Kurti dhe zyrtarëve të tjerë të pushtetit pas intervistës së O'Brienit, të cilët pretenduan se partneriteti ShBA - Kosovë nuk është prekur dhe mund të mos preket nga kjo situatë, duke shtuar se "duhet të jem i qartë se kjo nuk është aspak e vërtetë. Nuk është kështu". Në këtë drejtim ai ka thënë se është "gjë e rrallë" që Kosova të kritikohet nga ShBA-ja në Këshillin e Sigurimit të OKB-së

thënë se nuk është në pozitën për të folur për ndonjë masë specifike. "Kjo na bëhet shpesh si pyetje. Është bërë e njëjta gjë edhe në Departamentin e Shtetit. Dhe është thënë se nuk jemi në pozitën për të folur për ndonjë masë specifike dhe këtë mund ta them edhe unë. Por po them prapë, siç e ka thënë z. O'Brien, ne do të shpresonim që qeveria dhe kryeministri Kurti do të angazhohen si partnerë që ta zgjidhim këtë çështje së bashku në vend se të marrë veprime të njëanshme", ka thënë Hovenier. Deklaratat e ashpra të ambasadorit amerikan në Prishtinë vijnë një ditë pasi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tentoi t'i hedhë poshtë sugjerimet e ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, James O'Brien, i cili tha se Kosova po e rrezikon partneritetin me Shtetet e Bashkuara pas vendimit për ndalimin e dinarit serb. "Republika e Kosovës nuk ka partner, aleat dhe mik të rëndësishëm sikurse Shtetet e Bashkuara, kështu e konsideroj dhe bashkëpunoj unë si kryeministër i Kosovës", ka thënë Kurti të mërkurën. O'Brieni ka paralajmëruar të martën se Shtetet e Bashkuara mund të mos e trajtojnë Kosovën si partnere nëse ajo merr vendime pa u konsultuar me të, pas vendimit për ndalimin e

dinarit serb. "Unë nuk bëj kërcënime të vagëta publikisht. Unë do të thosha, nëse ne nuk trajtohem si partnerë, edhe ne nuk do ta trajtojmë Qeverinë e Kosovës si partnere", ka thënë O'Brieni në një intervistë për "Zërin e Amerikës".

Hovenieri ka thënë se ndihet i shqetësuar nga deklaratat publike të Kurtit dhe zyrtarëve të tjerë të Kosovës pas intervistës së O'Brienit, të cilët pretenduan se partneriteti ShBA - Kosovë nuk është prekur dhe mund të mos preket nga kjo situatë, duke shtuar "duhet të jem i qartë se kjo nuk është aspak e vërtetë. Nuk është kështu".

Të hënën BQK-ja ka njoftuar se faza e tranzicionit të zbatimit të rregullores së saj do të zgjasë deri në tre muaj, ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se Kosova nuk do të heqë dorë nga vendimi për ndalimin e dinarit për pagesa me para të gatshme, por se ai po i respekton kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare për këtë çështje.

Por, Hovenieri ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk i ka dëgjuar kërkesat e ShBA-së për shtyrjen e zbatimit të vendimit të rregullores. Ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara i kishin kërkuar Qeverisë së Kosovës dy gjëra specifike në lidhje me vendimin për zbatimin e rregullores së BQK-së. "E para, duhet të

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 15 SHKURT - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka thënë se vendimi i Kosovës për ta zbatuar vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për ndalimin e dinarit serb ka ndikuar në cilësinë e marrëdhënieve në mes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Qeverisë së Kosovës. "Më lejoni të theksoj sa problematik është ky moment, saqë qeveritë tona nuk duket se po punojnë në partneritet me njëra-tjetrën. Prandaj, dua që t'i shmangim gjëra të tjera si këto", ka thënë Hovenieri në një konferencë për medie të enjten para Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë.

Ai ka thënë se deklaratat e zyrtarëve amerikanë kanë qenë vazhdimisht të qarta se Kosova

duhet ta shtyjë vendimin e zbatimit të rregullores së BQK-së. "Ne kemi shpresuar se qeveria e kryeministrit Albin Kurti do të angazhohej, siç bëjnë partnerët, për ta zgjidhur këtë çështje së bashku, në vend se të merren veprime në mënyrë të njëanshme... ne jemi të shqetësuar që qeveria e Kurtit nuk e ka bërë këtë. Çfarëdo sugjerimi se gjërat janë në rregull, se ne të gjithë pajtohemi me njëri-tjetrin, nuk është aspak i vërtetë. Ne jemi të shqetësuar dhe të frustruar dhe mendoj se toni i ndihmëssekretarit O'Brien e pasqyron këtë shumë qartë", ka thënë Hovenieri.

Hovenieri ka theksuar se është "gjë e rrallë" që Kosova të kritikohet nga Shtetet e Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke iu referuar fjalimit të ambasadores amerikane në OKB, Linda Thomas-Greenfield, e cila e ka

përsëritur kërkesën e shtetit të saj që Kosova ta pezullojë zbatimin e vendimit të BQK-së gjatë një seance më 9 shkurt ku u bisedua me kërkesë të Serbisë për çështjen e dinarit. "Është e rrallë që në Këshill të Sigurimit përfaqësuesi amerikan të thotë gjëra kritike për Qeverinë e Kosovës. Ambasadorja Linda-Thomas Greenfield e bëri këtë. Është e rrallë që ndihmëssekretari për Evropë, James O'Brien, të japë intervistë me tone e kontekst të tillë siç e bëri. Është shumë e rrallë. Reflekton për një problem. Shpresa ime është të ndalet kjo. Nuk duam të jemi në këto rrethana. Duam të jemi në rrethana të tjera", ka deklaruar diplomati amerikan. Ambasadori Hovenier ka folur për mundësinë e ndonjë mase sanksionuse ndaj Kosovës nëse qeveria nuk reflekton ndaj kërkesës së ShBA-së. I pyetur për këtë çështje, ai ka

Blinkeni shpreh mirënjohje për partneritetin me Shqipërinë

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, të enjten ka vizituar Shqipërinë. Me këtë rast, ai ka shprehur mirënjohje për partneritetin e ShBA-së me shtetin shqiptar. Blinkeni gjatë qëndrimit në Tiranë ka lavdëruar edhe Edi Ramën, duke e quajtur lider të shquar dhe kryeministër shumë të mirë

TIRANË, 15 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, të enjten ka vizituar Shqipërinë. Gjatë qëndrimit në Tiranë ai është takuar me liderët e shtetit shqiptar. Blinkeni është shprehur mirënjohës për partneritetin me Shqipërinë gjatë një takimi me të rinj te Piramida në Tiranë, ku është shoqëruar edhe nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

Blinkeni ka thënë se gjatë mandatit të tij në krye të diplomacisë amerikane ka gjetur një partner të besueshëm te kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, duke theksuar se ai ka qenë "pranë nesh dhe vështirësitë i kemi tejkaluar së bashku".

"Ju falënderoj për një mirëpritje të mrekullueshme në vendin e shqiptarëve. E ndiej ambientin e ngrohtë jashtë, por ndiej edhe ngrohtësi në këtë dhomë dhe dhomën tjetër që kam qenë në Tiranë. Nuk mund t'ju shpjegoj se sa mirënjohës jam. Është një moment i rëndësishëm dhe vlerësim për punën tuaj për ta forcuar marrëdhënien midis vendeve tona. Jam shumë i lumtur që jam sot me ju në një qytet që ju si ish-kryetar bashkë i keni dhënë ngjyra të bukura. Jam mirënjohës për partneritetin e jashtëzakonshëm që ne të dy kemi. Kryeministri është jo vetëm udhëheqës i shquar, por edhe kryeministër shumë i mirë. Këto 3-4 vitet e fundit që kemi punuar, z. kryeministër ka qenë pranë nesh dhe i ka përballuar këto vështirësi së bashku me ne", ka thënë Blinkeni, i cili ka folur fjalë të mirë për shqiptarët kudo që jetojnë.

"Amerikanët të rinj dhe jo shumë të rinj po vallëzojnë gjithë natën me Dua Lipën. Shefja e teknologjisë në 'Open AI' është Mira Murati. Në Nju-Jork një nga restorantet më të mira është një restorant shqiptar. Këta janë disa shembuj që shpjegojnë një gjë shumë më të madhe, kapërcimi i Shqipërisë në botën e re nuk ishte aq i thjeshtë sa t'i hapësh dritat, sekreti ishte te njerëzit e rinj si ju që e krijuan ndryshimin. Të rinjtë si ju janë thelbësorë për të transformuar të ardhmen e Shqipërisë. Mes nesh kemi gazetarë që po ekspozojnë korrupsionin, kemi gra sipërmarrëse që fillojnë bizneset e tyre dhe po e bëjnë Shqipërinë edhe më të hapur. Disa prej jush kanë mirëpritur familjet afgane dhe kjo tregon bujarinë e Shqipërisë", ka thënë ai.

Sekretari Blinken nuk e ka përjashtuar as mundësinë e një vizite të dytë në Shqipëri. "Unë e pashë sot në rrugët e Tiranës. Mund ta shikoni energjinë për të ardhmen, një e ardhme e integruar me Perëndimin, Evropën dhe botën. Vitin e kaluar një numër rekord turistësh vizituan Shqipërinë. Ekipi juaj i futbollit u kualifikua për herë të dytë në Kampionatin Evropian. Në vitin 2016 ishte hera e fundit që një sekretar Shteti vizitoi Shqipërinë. Ndoshta unë do të vij gjatë finaleve të Kupës Evropiane dhe ndoshta mund t'ju ndihmoj", ka thënë ai.

Ndërsa kryeministri Rama i ka thënë sekretarit amerikan se "çelësat e shtëpisë sonë janë të sigurta me Blinkenin". "I nderuar Tony, unë kam lajme për ju sot:



Diktatori ynë për të cilin kjo piramidë u ndërtua, po rrotullohet në varrin e vet. Ai na rriti me urrejtjen dhe për t'ju luftuar. Ai na mësoi që t'ju urrejmë. Por sot ju mirëpresim dhe urojmë marrëdhënien tonë. Ky tempull i zgjeron horizontet e rinisë sonë. Shumë nga pronarët e kësaj piramide do të donin të ishin këtu. Ata e dinë që ju nuk keni synime të këqija. Ju uroj mirëseardhje. Shtëpia e shqiptarit i përket Zotit dhe mikut. Çelësat e shtëpisë sonë janë të sigurt me ju dhe ju jeni të sigurt në mesin tonë. Ne nuk jemi aq të mëdhenj sa vendet e tjera, por ne jemi në vend të parë për sa i përket dedikimit tonë dhe nuk jemi aq të mërziqshëm

sa vendet e tjera mund të jenë. Ju falënderoj që jeni në mesin tonë sot dhe ju falënderoj që sollët me ju dikë që ka lënë shpresë në të ardhmen tonë të përbashkët", ka thënë Rama.

Përpos Ramës, Blinkeni është takuar edhe me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj. "Jemi falënderues për atë që ShBA-ja ka bërë dhe ju po bëni për demokracinë shqiptare, sundimin e ligjit, veçanërisht reformën në drejtësi, mbrojtjen, sigurinë dhe sigurinë kibernetike, arsimimin dhe ekonominë përmes programeve të ndryshme mbështetëse. Shqipëria është e përkushtuar të vazhdojë të kontribuojë së bashku me ShBA-në dhe NATO-

n për sigurinë rajonale dhe globale", ka thënë Begaj.

Po ashtu, Blinkeni është takuar edhe me kryetarin e Tiranës, Erion Veliaj.

Në kuadër të vizitës në Shqipëri, Blinkeni është takuar me disa prej familjeve afgane që janë duke pritur të shkojnë në ShBA. Kryediplomati amerikan ka falënderuar Shqipërinë për strehimin e afër 2 500 afganëve që kanë ikur nga Afganistani pas rikthimit në pushtet të talibanëve në gushtin e vitit 2020. "Udhëtimi i tyre nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e Shqipërisë. Nuk është vetëm fakti që po i prisni ata, por edhe mënyra se si po e bëni këtë", ka thënë Blinkeni.

vendoset një procedurë përmes së cilës Serbia mund t'i transferojë fondet në përputhje me rregulloren e Bankës Qendrore, por kjo nënkupton standarde dhe praktika evropiane. Vendosja e kësaj procedure duhet të diskutohet në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Presim nga Kosova dhe Serbia të angazhohen në mënyrë

konstruktive në këtë. E dyta, derisa të punohet për ta zbatuar këtë proces afatgjatë, duhet të ketë provizione të përkohshme për ta lejuar Serbinë të vazhdojë të ofrojë fonde për shërbime të nevojshme sociale, përfshirë pagesat sociale, si pensionet, mbështetjen për sistemin e shëndetësisë dhe arsimin. Deri tani nuk ka pasur përpjekje për ta

mundësuar këtë në baza të përkohshme", ka thënë Hovenieri. Serbia e ka kritikuar ashpër rregulloren e BQK-së, duke e interpretuar si synim të Qeverisë së Kosovës për dëbim të serbëve. Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

Banka Popullore e Serbisë i ka dërguar prej vitësh dinarët në një kasafortë në komunën e Leposaviqit, në veri të Kosovës, dhe ato më pas janë transportuar nga kompania ndërkombëtare "Henderson".

BQK-ja ka thënë se një praktikë e tillë është e paligjshme, pasi vetëm ajo mund të bëjë eksport dhe import të monedhave dhe

brenda territorit të Kosovës.

Kushtetuta e Kosovës përcakton që duhet të ekzistojë vetëm një valutë për kryerje të pagesave me para të gatshme.

Kosova nuk është pjesë e Eurozonës të cilën e përbëjnë 20 vende anëtare të Bashkimit Evropian, por e ka euron si valutë kryesore që prej vitit 2002.

Mungesa e Listës Serbe lë pezull votimin e ndryshimeve kushtetuese për vetingun

Prishtinë, 15 shkurt - Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur t'i miratojë tri amendamentet kushtetuese të propozuara në lidhje me vetingun në drejtësi.

Pushteti dhe opozita janë pajtuar me këto tri amendamente, por kanë shprehur kundërshtime sa i

përket vetingut. Pavarësisht prej pajtueshmërisë pozitive për këto amendamente, të njëjtat nuk janë votuar për shkak se janë nevojitur votat e Listës Serbe. Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Adnan Rrustemi, ka theksuar se

komisioni i ka shqyrtuar propozim-amendamentet dhe, pas disa ndryshimeve, përfshirë renditjen e propozim-amendamenteve, i ka rekomanduar Kuvendit t'i miratojë.

Ai ka thënë se ka pasur një konsensus politik në komision për zhvillimin e

Procesit të vlerësimit kalimtar ose vetingut.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i PDK-së Abelard Tahiri, ka thënë se vetingu është proces i pashmangshëm dhe se si grup i kanë dhënë mbështetje. Në anën tjetër, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben

Gashi, ka theksuar se elementi i parë i dhënies së konsensusit për këtë veting ka qenë elementi i edukimit politik për pushtetin aktual.

Më tutje, deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë se si parti i mbështesin tri propozim-amendamentet kushtetuese për vetingun.

UÇK-ja krijoi historinë e re të Kosovës



Hasan MUJAJ

Më 17 shkurt 2008 në Prishtinë lindi Vloca e dytë. Një ditë madhështore, e cila hyri në faqet e arta dhe më të ndriturata jo vetëm të historisë së Kosovës, por edhe në ato të Rilindjes Kombëtare Gjithëshqiptare e ndërkombëtare. Kosova, shtet i pavarur. Ky emërtim, i kësaj date, qe kryetitull i mediebotëve.

Kështu, këtë ditë, u përmbys një padrejtësi e madhe dhe u trupëzua një e drejtë kombëtare e ndërkombëtare siç u vërtetua edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës. Sepse, Kosova ishte aneksuar nga Serbia nën masat e dhunshme të administrimit ushtarak që u vendos në Kosovë më 8 shkurt 1945 me seli në Prizren dhe ky aneksim, nën komandën e gjeneralëve serbë, u tumir edhe nga lideri jugosllav Josip Broz Tito! Do mbajtur parasysh fakti se, gjatë këtij administrimi, u vranë me mijëra shqiptarë.

Fjalimin historik të shpalljes së Kosovës shtet i pavarur, në Kuvendin e Kosovës, e mbajti kryeministri i Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi. Këtë ditë festoi e tërë Kosova. Festoi Shqipëria. Mërgata shqiptare kudo që gjendet. Festuan shqiptarët e shteteve përreth Kosovës. Pra, e gjithë shqiptaria.

Qytetaret e qytetarët e të gjitha moshave, me të madh galdim e shendim, me fytyra të ngazëlluara e patos ndjenjash të zjarra nga frymëzimi i lartë atdhetar, me këngë e valle kushtuar astritëve të UÇK-së dhe gjithë dëshmorëve të kombit, po i hyznizonin e përhimnonin deri në kreshtë therorët e feniksët që u flijuan për këtë ditë, për lirinë e pavarësinë e Kosovës.

Kjo fitore lapidare, çlirimtare, kombëtare dhe identitare, pati rrugë të gjatë, shumë të gjatë udhëtimit, mbi njëshekullor derisa u trupëzua një pjesë e idealit kombëtar. Vetëm një pjesë! Sepse, implikatura duhet të vazhdojë, por në përputhje me ecuritë e kohës.... Ky sendërtim me shumë arsye, ndoqi disa faktorë si: strategjikë, historikë, politikë, lufta e armatosur dhe ndërhyrja ndërkombëtare.

Të frymëzuar nga e kaluara e lavdishme historike që nga koha e Gjergj Kastriotit dhe e heroizmit të këtij strategu zulmëmadr për ta zhvilluar identitetin kombëtar dhe për ta themeluar shtetin shqiptar, të inspiruar nga programi kombëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878), nga Lidhja e Pejës (1899), të nxitur nga atdhetarizmi i kryengritjeve

jehuese të malësorëve të viteve 1909 - 1912 për ta mbrojtur Shqipërinë etnike nga pretendimet rrëmbyese të territoreve autoktone shqiptare nga shtetet fqinje, shqiptarët e shpallën pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë historike më 28 nëntor 1912.

Me gjithë këtë arritje historike, më shumë se gjysma e trojeve shqiptare mbeti jashtë kufijve të imponuar të shtetit shqiptar. Veprimtaria kombëtare shqiptare kundër rrëmbimit me luftë të krahinave të Shqipërisë etnike pati ecuri të gjatë lufte me penë e me armë edhe në Kosovë. Ajo, gjatë historisë, reagoi në vijimësi ndesh diskriminimit nacional që u bëhej shqiptarëve nga politika ekspansioniste e Millosheviqit për të vazhduar ajo e Vuçiçit gjithnjë deri në krimin e Banjskës. Dhe, sa më represive që bëheshin masat e pushtetit të dhunshëm të Beogradit zyrtar ndaj Kosovës, aq më masive dhe më aktive bëhej rezistenca shqiptare për të drejtat kombëtare.

Zatën burgosjet, dhuna, vrasjet e forma të tjera të krimeve ndaj shqiptarëve nga pushteti serb, qenë të vazhdueshme. Ato u ashpërsuan, sidomos nga viti 1956 nën diktatin e ministrit të Punëve të Brendshme, serbit antishqiptar A. Rankoviçit gjatë të quajturit "aksion i mbledhjes së armëve" të shqiptarëve të Kosovës. Ky qe "aksion..." i improvizuar ndesh shqiptarëve, i cili vazhdoi rreth dhjetë vjet, saktësisht deri në Plenumin e Brionëve që u mbajt në korrik të vitit 1966 kur u bë rënia e Rankoviçit nga pushteti, u bënë krime shumë të mëdha.

Kjo rezistencë u manifestua publikisht në vjeshtën e vitit 1968 nga demonstratat paqësore të studentëve në disa qytete të Kosovës: në Prizren, Pejë, Prishtinë etj., të cilat u zgjeruan edhe nga shtresat e tjera shoqërore si: intelektualë, bujq, zejtarë, nxënës etj. Kërkesat e demonstruesve qenë: përdorimi i lirë i Flamurit Kombëtar, themelimi i Universitetit të Prishtinës, vetëvendosja, avancimi i statusit politik të Kosovës në republikë etj.

Demonstratat e këtij viti shënuan një labërgim të veprimtarisë politike për të drejtat kombëtare. Si rrjedhojë e kësaj ecurie, vitet e '70-ta qenë të favorshme për Kosovën: u themelua Universiteti i Prishtinës, u lartësua statusi politik-kushtetues i Kosovës si njësi federale e Jugosllavisë në vitin 1974, u hap bashkëpunimi arsimor, shkencor e kulturor etj. me Shqipërinë, u hapën studimet pasuniversitare në degën e albanistikës dhe të historisë etj.

Këto arritje i dhanë shtysë përforcuese zhvillimit, konsolidimit e bashkërendimit të lëvizjes kombëtare, e cila, në demonstratat që u nisën nga studentët e Universitetit të Prishtinës më 11 mars 1981 dhe u bënë gjithëpopullore, kërkesë

parësore qe ngritja e statusit politik të Kosovës në republikë. Demonstratat e këtij viti qenë masive e tërmet i shkallës së lartë dhe dridhen themelin e Jugosllavisë së atëhershme.

Zhvillimet politike në Kosovë, nga fundi i viteve të '80-ta dhe më tej në vijim, sa vinin e po ndërlikoheshin si pasojë e masave të dhunshme të pushtetit serb në të gjitha fushat e veprimtarisë, prandaj pasuan: përjashtimi nga puna i mijëra punëtorëve, mbyllja e institucioneve të arsimit të të gjitha niveleve, mbyllja e të gjitha medieeve në gjuhën shqipe, vrasjet e burgosjet e veprimtarëve aktivë etj.

Zhvillimet vijuese do kundruar nga këta konstituentë: veprimtaria e faktorit politik shqiptar për zgjidhjen paqësore; ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar; imponimi i luftës së armatosur; dorëzimi i Serbisë dhe nënshkrimi i kapitullimit të saj në Kumanovë; themelimi i institucioneve demokratike të Kosovës shtet.

Veprimtaria e faktorit politik

Qe fillimi i viteve të '90-ta. Fillimi i ndryshimeve të mëdha politike. Edhe në Kosovë kishte zënë e po vegonte një puhizë e demokracisë. Shqiptarët e Kosovës, masivisht e publikisht, braktisën diktaturën e sistemit komunist. Ata kërkonin demokracinë dhe sendërtimin e vullnetit të popullit. Ngjashëm u veprua edhe në disa njësi të tjera federale të ish- Jugosllavisë duke shënuar kështu rënien përfundimtare të saj.

Asokohe shqiptarët, me të drejtë, u përcaktuan për dy politika: politika e rezistencës paqësore dhe, në konspiracion, përgatitja për luftën e armatosur në rast dështimi të së parës. Politika e rezistencës paqësore, e cila drejtohej nga lideri demokrat dr. Ibrahim Rugova, bëri jehonë të madhe diplomatike ngase i arsyei dhe i afirmoi kërkesat e drejta të shqiptarëve për lirinë dhe demokracinë në relacionet me të larta ndërkombëtare. Ajo, nën masat e represionit e të gjenocidit të politikës së S. Millosheviqit ndaj shqiptarëve, krijoi sistemin e arsimit paralel në shtëpitë - "shkolla", një lloj të vetëfinancimit simbolik, themeloi disa medie të pavarura informimi, një imitim të pushtetit paralel në disa komuna etj.

Kjo strategji (rezistenca aktive paqësore), në fillim, i duhej Kosovës për ta bindur faktorin ndërkombëtar se shqiptarët qenë për zgjidhjen paqësore, me dialog demokratik dhe se Beogradi zyrtar po bënte krime ndaj shqiptarëve të Kosovës. Prandaj, vitet e rezistencës aktive nuk qenë vite të humbura siç u quan një akademik yni në veprën me titull "Vite të humbura"; kjo politikë siguroi mbështetjen e faktorit

ndërkombëtar sikundër u dëshmuua më vonë.

"UÇK-ja, shpëtimtarja e kombit shqiptar" - tha Ismail Kadare

Pasi u vërtetua se politika e paqes nuk solli marrëveshje me një agresor që i vuri në veprim të gjitha mjetet e dhunës për t'i shkelur me forcat ushtarake e policore të gjitha të drejtat njerëzore e kombëtare të rreth dy milionë shqiptarëve të Kosovës, u imponua lufta e armatosur.

Tani doli publikisht një forcë e re; e vogël nga numri, por e madhe, shumë e madhe nga morali i luftës. Doli UÇK-ja, e cila, ndonëse me armatim modest, por e betuar përpara Flamurit Kombëtar për t'u flijuar për lirinë e Kosovës dhe, e mbështetur nga shtresat e gjera popullore, jo vetëm që fitoi disa beteja në përballjen me forcat ushtarake e policore serbe shumë më të mëdha në numër dhe me armatim modern, porse krijoi panik të paparë të njësitë e forcave të armatosura serbe. UÇK-ja zhvilloi luftë mbrojtëse dhe të drejtë. Ajo nuk bëri masakra mbi popullatën civile serbe siç bënë ushtria e policia serbe mbi popullatën e paarmatosur shqiptare; ajo nuk vrau fëmijë, gra e të moshuar siç vranë ushtria e policia serbe; ajo nuk dhunoi e nuk dogji vendbanimet e popullatës serbe sikundër dogjën shtëpi e banorë shqiptarë ushtria e policia serbe e krime të tjera. Këto veprime kriminale u vërtetuan edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për krimet e luftës.

Masakrat e ushtrisë e të policisë serbe mbi popullatën civile shqiptare u bënë me diktatin e Beogradit zyrtar dhe u dëshmuuan edhe në relacionet botërore si p.sh. masakra mbi familjen e komandantit të UÇK-së Adem Jashari në Prekaz për të vazhduar me masakrat në fshatrat: Reçak, Qyshk, Lybeniq, Meje, Krushë e Vogël, Likoshan e shumë të tjera, të cilat zgjuan ndërjegjen e intervenimit të faktorit ndërkombëtar.

Intervenimi i NATO-s

Faktori ndërkombëtar bëri përpjekje të vazhdueshme që çështja e Kosovës të zgjidhej me dialog. Me gjithë vërejtjen se do të ketë intervenim për t'i ndërprerë masakrat mbi popullatën civile shqiptare, këto përpjekje i hodhi poshtë politika serbe, e bindur se Kosovën do ta nënshtrijë me forcë.

Pas refuzimit të Beogradit për ta nënshkruar marrëveshjen paqësore të Rambujesë dhe pas deportimit të dhunshëm të mijëra shqiptarëve nga vendbanimet e tyre, u imponua ndërhyrja e NATO-s, e cila, (ndërhyrje) në bashkërendim me UÇK-në, pas shtatëdhjetë e tetë ditësh të bombardimeve të objekteve e të caqeve ushtarake e policore serbe

në Kosovë dhe në Serbi, detyroi nënshkrimin e dorëzimit të Serbisë dhe përjashtimin e të gjitha forcave ushtarake e policore serbe nga Kosova. Kështu politika e Millosheviqit, pjesëmarrës i së cilës ishte edhe A. Vuçiçi, e humbi luftën, d.m.th. e humbi Kosovën, nga e cila, vijuesi i politikës së tij-Vuçiçi, po provon ta aneksojë pjesën veriore të saj. Liria e Kosovës u fitua me flijime të mëdha: me mijëra viktime të popullatës civile shqiptare nga krimet e forcave serbe; shumë sypëtrinë të UÇK-së ranë dëshmorë të kombit në fushëbeteja, u bënë djegie të shtëpive dhe vjedhje të pasurive të shqiptarëve nga ushtria e policia serbe.

Themelimi i institucioneve demokratike të Kosovës

Themelimi i institucioneve të reja demokratike doli nga rezultati i zgjedhjeve të lira e demokratike të Kosovës, të cilat, siç u vlerësuan edhe nga vëzhguesit ndërkombëtarë, qenë korrekte e të drejta. Në këtë mënyrë Kosova dha prova të pakontestueshme se ishte e përgatitur të funksionojë si shtet sovran, demokratik, shumetnik dhe do të jetë faktor paqeje e stabiliteti në rajon.

U bë konstituimi i Kuvendit të Kosovës, u hartuan dhe u miratuan shumë ligje të reja në frymën e demokracive të avancuara, u hartua dhe u miratua Kushtetuta e shtetit, u themelua Gjykata Kushtetuese e shumë institucione të tjera.

Si kriter i radhitjes së kokonstituentëve me relevancë vendimtare për lirinë e pavarësinë e Kosovës, u mor faktori kronologjik si në vijim: Ushtria Çlirimtare e Kosovës; Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në atë kohë, në mandatin president të B. Klintonit; në krye me ShBA-në, edhe shtetet e fuqishme me forcë të madhe ndikimi si: Britania e Madhe me në krye kryeministrin T. Bler, Gjermania, Italia, Franca etj.; mërgata shqiptare anekënd shtetve të saj në përmasat botërore si me mjetet financiare, ashtu edhe me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në luftën e armatosur; qarqet intelektuale dhe akademike me fjalime, reagime e publikime të ndryshme; gazetarët e medieeve të shkruara dhe elektronike që pasqyronin të vërtetën për krimet e ushtrisë e të policisë serbe në Kosovë; politika konstruktive dhe diplomacia e Shqipërisë me jehonë, sidomos në relacionet ndërkombëtare dhe me mbështetjen e gjerë në disa aspekte të luftës dhe të mikpritjes së qytetarëve të deportuar me dhunë nga ushtria e policia serbe etj.

Republika e Kosovës u pranua shtet i pavarur nga mbi njëqind e dhjetë shtete. Lavdi e përhershme të gjithë dëshmorëve të kombit! Gëzuar 16-vjetori i pavarësisë së Kosovës!

Vazhdon puna e grupit punues për reformën në drejtësi

PRISHTINË, 15 SHKURT - Kanë filluar punimet treditore të Grupit Punues për hartimin dhe finalizimin e legjislacionit që rrjedh nga Deklarata e Përbashkët e Zotimit, në të cilën morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës si dhe partnerë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të shoqërisë

civile. Gjatë kësaj punëtorie është diskutuar për kornizën përkatëse ligjore e cila do të shqyrtohet në zbatim të Deklaratës së Përbashkët të Zotimit si dhe legjislacionin përkitazi me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjatë kësaj punëtorie zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, tha se ky proces

i përbashkët me institucionet e drejtësisë ka për qëllim përmirësimin rrënjësor të sistemit të drejtësisë dhe është një iniciativë e cila do të kontribuojë në jetësimin e përpjekjeve të vazhdueshme për reformën në drejtësi. Më tutje zëvendësministri Qorrolli tha se reforma në drejtësi rrjedhë si domosdoshmëri e identifikuar në procesin e



Rishikimit Funkcional të Sundimit të Ligjit, raporteve të ndryshme të BE-së për vendin, opinionit të

Komisionit të Venecias si dhe raporteve dhe vlerësimit të organizatave të tjera vendore dhe ndërkombëtare.

KDI-ja lanson platformën e gjelbër digjitale



PRISHTINË, 15 SHKURT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me dymbëdhjetë organizata partnere, ka lansuar platformën digjitale që promovon aktivizimin e gjelbër në komunitet. Me lansimin e kësaj ueb-platforme të gjithë qytetarët e vendit nga sot do të kenë një mjet shtesë në dispozicion për t'i shpërfaqur dhe raportuar rastet e degradimit të mjedisit në lagjet e tyre dhe në hapësirat publike ku ata gravitojnë. Ndërsa institucionet lokale e qendrore do ta kenë një hartë të problemeve mjedisore, ku janë të vizualizuara rastet e ndotjes së ajrit, tokës, lumenjve, deponitë

ilegale, shkatërrimi i pyjeve, betonizimi i hapësirës së gjelbër - të gjitha të raportuara në kohë reale. Si një instrument që do ta nxisë komunikimin e qytetarëve me komunat, platforma, përveç që do ta rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për të qenë aktiv në luftimin e degradimit mjedisor, do të shërbejë edhe si katalizator i zgjidhjes së këtyre problemeve nga institucionet lokale dhe qendrore. "Gjatë muajve të fundit, KDI, në bashkëpunim me 12 organizata lokale, përmes vizitave në terren, kanë identifikuar dhe dokumentuar dhjetëra zona natyrore të degraduara si pasojë e hedhjes së paligjishme të

mbeturinave e mbetjeve inerte, shpyllëzimit të pakontrolluar e derdhjes së ujërave të zeza dhe kimikateve në lumenj e liqene në dymbëdhjetë komuna të Kosovës. Gjatë këtyre vizitave u grumbulluan fakte që dëshmojnë për nivel alarmant të ndotjeve mjedisore dhe u dëgjuan rëfime të qytetarëve që jetojnë afër mbi efektin e këtyre ndotjeve në jetën e tyre të përditshme. Vizita si kjo, por edhe ndotje të tjera që po ndodhin gjithandej Kosovës, ngrahin nevojën për intervenim urgjent nga institucionet në mënyrë që të evitohet rreziku publik nga këto degradime", ka theksuar Ardian Muçaj nga KDI-ja.

Funksionalizohet shërbimi i Rezonancës Magnetike në Spitalin Regjional të Prizrenit, përfitojnë edhe qytetarët e Kukësit



PRIZREN, 15 SHKURT - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministrja Emilija Rexhepi dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, morën pjesë në përirimin e Rezonancës Magnetike (MRI) në Spitalin Rajonal të Prizrenit, ku u pritën nga drejtoresha e këtij spitali, Narqize Arënlju-Hoxhaj. Pas spitalit rajonal të Pejës dhe Klinikës së Pediatriisë në Prishtinë, spitali rajonal i Prizrenit bëhet institucioni i tretë shëndetësor që pajiset me aparaturë të Rezonancës Magnetike brenda një periudhe njëvjeçare.

Kryeministri Kurti ka theksuar se angazhimi në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe në përmirësimin e cilësisë së tyre do të jetë i vazhdueshëm. "Sistemi dytësor po forcohet e qytetarëve në secilin region të vendit. Fokusi ynë si qeveri është investimi i aparaturave moderne, duke përfshirë edhe spitalet rajonale", ka thënë Kurti. Ndërsa ministri Vitia ka pohuar se me funksionalizimin e kësaj rezonance do të ulët lista e pritjes në minimum dhe se nga ky shërbim i ri do të përfitojnë edhe

qytetarët e Kukësit. Pasi që janë adaptuar hapësirat dhe sigurimi i të gjitha procedurave, kjo pajisje u funksionalizua dhe se qytetarët e kësaj zone rajonale nuk do të kenë nevojë të udhëtojnë për në Prishtinë për të realizuar një procedurë të tillë. Me këto investime po u mundësohet pacientëve tanë qasje më e lehtë në shërbime shëndetësore. Me rastin e përirimit të MRI-së, në vlerë prej 908.653 eurosh, të pranishëm ishin edhe zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha dhe drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi.

Konjufca vlerëson bashkëpunimin me Norvegjinë dhënë për Kosovën

PRISHTINË, 15 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e ri jorezident të Mbretërisë së Norvegjisë për Republikën e Kosovës, Andreas Gaarder. Në takim, ndër të tjera, u bisedua për marrëdhëniet dypalëshe, shtimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit, vazhdimin e mbështetjes së shtetit norvegjez për Kosovën në rrugën integruese euroatlantike, si dhe u shkëmbyen pikëpamje lidhur

me zhvillimet në vend dhe rajon. Konjufca, pasi i dëshiroi suksese ambasadorit Gaarder në detyrën e re, vlerësoi lart marrëdhëniet mes dy shteteve tona, të cilat bazohen në miqësi të palëkundur, partneritet dhe respekt të ndërsjellë. Ai, po ashtu, shfaqti shpresën se gjatë mandatit të ambasadorit Gaarder do të forcohen dhe shtohen edhe më tej raportet e dyanshme. Me këtë rast, kryetari i Kuvendit i shprehu mirënjohje ambasadorit

norvegjez për mbështetjen që Norvegjia i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë Republikës së Kosovës në shumë fusha, përfshirë anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar. Ambasadori Gaarder falënderoi kryetarin Konjufca për pritjen, ndërsa konfirmoi gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në sfera me interes të përbashkët ndërmjet Norvegjisë dhe Republikës së Kosovës.



Avokati i Popullit i drejtohet Kushtetueses, kërkon largimin e "15-vjetëshit" nga Ligji për Skemat Pensionale

PRISHTINË, 15 SHKURT - Avokati i Popullit e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 4 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Skemat Pensionale të financuara nga shteti. "Çështja e ngritur nga Avokati i Popullit ka të bëjë me stazhin kontributpagues i përcaktuar me nenin 8 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, për të cilin Avokati i Popullit, më 6 prill 2018, ka publikuar raportin me rekomandime ex officio 235/2018, ku ka theksuar se një pjesë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës, për shkak se në vitin 1989 e tutje janë larguar nga puna në mënyrë diskriminuese si pasojë e masave të dhunshme dhe se për këtë arsye nuk kanë mundur të arrijnë stazhin kontributpagues prej 15 vjetësh", theksohet në njoftimin e këtij institucioni për medie.

Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti kishte kërkuar ndryshimin e ligjit dhe përfshirjen në skemën pensionale kontributpaguese të të gjithë qytetarëve, të cilët, për shkak të largimit të dhunshëm nga puna, nuk kanë pasur mundësi ta arrijnë stazhin pensional prej 15 vjetësh të përcaktuar me ligj. "Në këtë drejtim, edhe Gjykata Kushtetuese nëpërmjet Aktgjykimin KO 190/19, të datës 16 janar 2023, kishte konstatuar se Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti nuk është në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese ka urdhëruar Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, respektivisht, që deri më 15 korrik 2023 të ndërmarrin veprimet e

nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim. Ligji i kontestuar ka hyrë në fuqi më 16 gusht 2023, i cili, mes të tjerash, e shton nenin e quajtur 'Pensioni parcial kontributpagues i moshës' i cili, sipas Avokatit të Popullit, nuk e zgjidh problemin për shkak se një numër qytetarësh të dëbuar nga puna si pjesë e masave të dhunshme mbesin përsëri jashtë kësaj skeme. Avokati i Popullit konsideron se mbajtja si kriter i stazhit kontributpagues për 15 vjet vazhdon t'ua mohojë realizimin e të drejtës qytetarëve të dëbuar nga puna e që si pasojë e kanë të pamundur ta përmbushin këtë kriter", theksohet në këtë njoftim. Avokati i Popullit vlerëson se në këtë mënyrë këtyre qytetarëve u mohohet e drejta për trajtim të barabartë para ligjit, ashtu siç është përcaktuar edhe në Aktgjykimin KO 190/19.



Oda Amerikane propozon alternativa për transaksionet me dinarin serb

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 SHKURT - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka reaguar me rastin e miratimit të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme nga Banka Qendrore e Kosovës, që tashme ka nxitur reagime të fuqishme nga palët ndërkombëtare të interesit. Derisa Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mirëkupton nevojën për mbikëqyrje rregullative me qëllim të sigurimit të stabilitetit financiar, është imperativ të konsiderohen edhe implikimet afatshkurtra që rregullimi ka në mirëqenien financiare të qytetarëve të Kosovës. "Rregullorja në fjalë, pa paragjykim ndaj objektivit aktual, në mënyrë jo të duhur, pihon që vetëm euro mund të përdoret për qëllime të pagesave brenda Kosovës, duke përjashtuar në mënyrë të efektshme përdorimin e valutave të tjera në transaksionet ndërmjet palëve. Sidoqoftë, është esenciale të thuhet që përderisa



euro mban statusin e mjetit ligjor të pagesave në Kosovë, kjo nuk përjashton përdorimin e valutave të tjera në transaksionet, në rastet kur palët e përfshira arrijnë dakordim reciprok. Kështu, pretendimi i rregullores në lidhje me përdorimin ekskluziv të euros

mund të keqinterpretohet, prandaj kërkon rishikim për qartësi", është thënë në reagimin e kësaj ode. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka theksuar se ndikimi i rregullores shtrihet më tej në transaksionet ndërshtetërore

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Në mundësimin e transaksioneve që përfshijnë dinarin e Serbisë, Oda Amerikane propozon disa alternativa për të siguruar të drejtën e qasjes, krahas ruajtjes së përputhshmërisë rregullative: Alternativa 1: Shfrytëzimi i institucioneve të transferit të parave për transferimin e fondeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Edhe pse konsiderohet si fizibil, ky opsion mund të jetë më pak praktik dhe më i kushtueshëm për individët. Alternativa 2: Krijimi i një llogarie bankare nga Qeveria e Serbisë në Serbi për transaksione ndërshtetërore me llogaritë përkatëse të denominuara në dinarë në bankat e Kosovës. Kjo metodë ofron një zgjidhje praktike nëpërmjet marrëdhënieve ekzistuese bankare, me gjithë komplikimet e mundshme logjistike. Alternativa 3: Transferet direkte të fondeve nga ndonjë bankë të Serbisë në ndonjë bankë të përcaktuar në Kosovë për shpërndarje në

llogaritë e përfituesve individualë. Ky opsion thjeshton procesin duke siguruar përputhshmërinë me kërkesat rregullative", është theksuar në këtë reagim. Në të gjitha alternativat, OEAK-ut ka theksuar se është e rëndësishme të adresohet licencimi i institucioneve për importim të valutave, për të siguruar një furnizim adekuat të dinarëve në Kosovë. "Duke qenë një avokuese për një mjedis të favorshëm biznesi dhe zhvillim ekonomik në Kosovë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë thekson rëndësinë e masave të balancuara rregullative, të cilat nxisin gjithëpërfshirjen financiare dhe lehtësojnë aktivitetet ekonomike ndërshtetërore. Oda Amerikane kërkon nga të gjithë hisedarët t'i rishqyrtojnë implikimet e rregullores së miratuar së fundmi dhe të eksplorojnë zgjidhje bashkëpunuese të cilat mbështesin objektivat rregullative si dhe pragmatizmin ekonomik", thuhet në fund të reagimit të OEAK-ut.

Policia ndërmerr aksion në rajonin e Prizrenit, arreston katër persona për falsifikim të parasë

PRISHTINË, 15 SHKURT - Me urdhër të Prokurorisë Speciale (PS), Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, ka ndërmarrë një aksion në rajonin e Prizrenit për kontroll të veturave. Gjatë këtij aksioni janë ndaluar dy vetura, "BMW X5" dhe "Shkoda", me katër

persona, për shkak të dyshimit se personat të cilët gjenden në këto vetura shpërndajnë para të falsifikuara. Gjatë kontrollit në veturën "BMW X5" është hasur sasia e parave të dyshuara si të falsifikuara në shumën prej 24 600.00 euro. Prokuroria Speciale njofton se në këtë rast janë sekuestruar 24 600.00 euro, dy automjete të

përdorura nga personat e dyshuar, si dhe nëntë telefona celularë. Po ashtu, të dyshuarit janë intervistuar në praninë e avokatëve mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare, si dhe të njëjtët janë shtetas të Republikës së Shqipërisë. Me aktvendim të Prokurorit nga Prokuroria Speciale, personat e dyshuar janë dërguar në mbajtje për 48 orë.



Përrshëndete Kamerën!

Pak përpara se të ndahej nga jeta në vitin 2016, Umberto Eko kishte përgatitur për botim një vëllim me ese të titulluar "Pape Satán Aleppe: Cronache di una società liquida." Ishte një dhuratë e fundit për lexuesit, që përmbante ese të botuara përgjatë viteve në rubrikën "La bustina di Minerva" të revistës së përjavshme italiane "L'Espresso." Esetë marrin shtysë nga konceptualizimi i asaj që sociologu dhe filozofi polak Zygmunt Bauman (Zygmunt Bauman) pati emërtuar si shoqëri likuide ne librin e tij "Moderniteti Likuid," botuar në vitin 2000. Në esenë e mëposhtme të botuar në vitin 2002, Eko analizon dëshirën e qenieve njerëzore për t'u bërë të njohur. Duke nisur me dëshirën e natyrshme për famë përmes zotësive dhe talenteve (reale ose të ekzagjeruara), Eko analizon zbehjen graduale të dallimit mes të qenit 'i njohur' dhe 'i përfolur' në shoqërinë moderne. Ai merr shtysë fillimisht nga dëshira e njerëzve për t'u parë nga kamera, qoftë edhe pas shpinës së dikujt që po intervistohet, apo për të marrë pjesë në programe televizive vetëm për famë dhe jo për të treguar ndonjë aftësi të veçantë. Duke qenë se periudha në të cilën eseja është shkruar i përket fillimeve të aksesit publik në internet, Eko bën edhe një parashikim të zëvendësimit të dëshirës për popullaritet lokal me atë të audiencës globale, duke mos qenë shumë larg të vërtetës që po dëshmojmë

Përrshëndete Kamerën!

Teksa ndërgjegjësohem për ngrohjen globale dhe zhdukjen e stinëve si pranvera e vjeshta, dhe këtë ma konfirmojnë artikujt të shkruar nga persona me autoritet, pyes veten se si do të reagojë nipi im, i cili ende nuk ka mbushur dy vjeç, kur të dëgjojë fjalën "pranverë," apo kur në shkollë të lexojë poezi për melankolinë e vjeshtës. Si do të reagojë ai në të ardhmen ndaj "Katër Stinëve" të Vivaldit? Ndoshta ai do të jetojë në një tjetër botë, me të cilën do të jetë plotësisht i mësuar dhe pranvera nuk ka për t'i munguar. Tek e fundit, si fëmijë, as unë nuk i kam parë e përjetuar dinosaurët e, prapëseprapë mund t'i përfytyroja. Ndoshta pranvera s'është veçse nostalgjia e një të moshuari, si ajo për netët e kaluara duke luajtur kukafshehti në strehët kundërajrore. Do të mundet vallë ky fëmijë i së ardhmes ta quajë normale jetesën në një botë ku virtyti kryesor do të jetë që të shihesh nga të tjerët; vlerë kjo, më e rëndësishme edhe se sa seksi apo paratë? Një botë ku njerëzit do të jenë gati të bëjnë gjithçka që të shihen në televizion ose çfarëdo mediumi që mund ta ketë zëvendësuar televizionin gjer atëherë, vetëm e vetëm që të jenë të njohur dhe të mos veprojnë nën peshën e frikshme e të papërballeshme të anonimitetit. Një botë ku gjithmonë e më shumë nëna të respektueshme do të jenë gati të rrëfejnë edhe historitë më të





Ilustrim i portretit të Umberto Ekos (Umberto Eco) gjeneruar përmes inteligjencës artificiale (DeepAI)

pahijshme familjare nëpër emisione historike prekëse, vetëm e vetëm që të nesërmen t'i njohin tek dyqani i lagjes dhe t'u kërkojnë autografe? Një botë ku vajzat e reja do të thonë se duan të bëhen aktore, siç thonë edhe sot, por jo për t'u bërë Marlene Dietrich (Marlene Dietrich) apo Greta Garbo e radhës, as për të performuar Shekspirin apo për të kënduar si Xhozefin Bejker (Josephine Baker), veshur vetëm me banane në skenën e Folies Bergère por, vetëm për të qenë një 'quiz girl' në televizion, thjesht për spektakël, pa asnjë lloj talenti. Do të duhet atëherë që dikush në të ardhmen t'i spiegojë këtij fëmijë në shkollë, krahas mësimëve për mbretërit e Romës dhe rënien e Berluskonit, apo për filma si "C'era una volta la Fiat"; se si qeniet njerëzore, qysh nga antikiteti, kanë dashur gjithmonë të njihen nga të tjerët rreth tyre. Se si disa përpiqeshin të ishin bashkëbisedues interesantë tek bari i lagjes, ndërsa të tjerë kërkonin të shkëlqenin në futboll ose si qitës të zotë në festalet e zonës, apo të mburreshin për

peshkun e madh që mund të kishin kapur. Se si vajzat donin të binin në sy për kapelën e bukur që kishin mbajtur veshur në ceremoninë e së dielës në kishë; gjyshet donin të njiheshin si kuzhineret apo rrobaqepëset më të mira të fshatit. Dhe mos e dhëntë zoti të mos ketë qenë kështu, sepse për t'u bërë të njohur, njerëzit duhet të tërheqin vëmendjen e Tjetrit dhe sa më të njohur të jenë, aq më të dashur e të admiruar bëhen për Tjetrin – dhe, nëse në vend të vetëm një Tjetri admirohen nga qindra ose mijëra të Tjerë, akoma më mirë. Kështu, në kohën e lëvizjeve të mëdha e të pandalshme, kur njerëzit lënë fshatrat dhe humbasin sensin e shtëpisë dhe Tjetri është thjesht dikush me të cilin komunikojnë përmes internetit, do të jetë e natyrshme për qeniet njerëzore të kërkojnë të bëhen të njohur në mënyra të tjera. Dhe kështu, sheshi i fshatit nis e zëvendësohet nga audiencia globale e transmetimeve televizive, apo gjithçka që do të vijë më pas. Surge in Measles Cases in UK Comes Amid Plummeting

Vaccination Rate Por, ndoshta edhe mësuesit e ardhshëm dhe ata që mund t'i zëvendësojnë, nuk do të mund të kujtojnë se në të shkuarën kishte një dallim të qartë mes të qenit i njohur dhe të qenit i përfolur. Dikur çdokush donte të ishte i njohur si harkëtar i zoti ose valltari më i mirë por, askush nuk donte të përfollet si brinari më i madh i fshatit, si impotent apo si kurvë. Përkundrazi, kurva do të pretendonte se qe kërcimtare, ndërsa impotenti do të sajonte histori aventurash seksuale të ekzagjeruara. Nëse bota e së ardhmes do t'i përngajë ndopak asaj çfarë është duke ndodhur, dallimi mes të qenit i njohur dhe i përfolur do të zhduket. Njerëzit do të bëjnë gjithçka "për t'u parë," dhe "për t'u përfolur." Nuk do të ketë më dallim mes famës së një imunologu të rëndësishëm dhe asaj të një të riu që vret nënën e tij; mes dashnorit të zjarrtë dhe burrit që fiton kampionatin botëror për penisin më të shkurtër; mes atij që trajton lebrozët në afrikë dhe dikujt që nuk paguan taksat. Në këtë drejtim, gjithçka do të vlejë për sa

kohë ndihmon që të shihesh nga të tjerët dhe të nesërmen të njihesh nga shitësi i lagjes ose sportelisi i bankës. Do të doja të pyesja cilindo që mendon se po tregohem apokaliptik se përse sot, njerëzit kur gjenden pas shpinës së dikujt që po intervistohet, kërkojnë me patjetër të shihen tekta përrshëndesin me dorë kamerën, ose përse marrin pjesë në një 'quiz show,' duke e ditur që nuk ka për t'iu ndryshuar jetën, ashtu sikurse një dallëndyshe e vetme nuk sjell pranverën. Po ç'rëndësi ka? Do të bëhen gjithsesi të njohur. Megjithatë, nuk po tregohem apokaliptik. Ndoshta, fëmija të cilit iu referova do të bëhet ndjekës i ndonjë sekti të ri, synimi i të cilit do të jetë fshehja nga sytë e botës, mërgimi në shkretëtirë, tërheqja në ndonjë manastir, apo dinjiteti i heshtjes. Në fund të fundit, kjo ka ndodhur një herë, në mbyllje të një epoke kur perandorët nisën të caktonin kuajt si senatorë. (Përkthyer për TemA nga Bjorn Runa)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova dhe Shqipëria shënojnë rënie në ranglistën e FIFA-s

Prishtinë, 15 shkurt - FIFA e ka publikuar renditjen e saj më të re në nivel të shteteve. Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pësuar rënie për një pozitë krahasuar me renditjen

paraprake. "Dardanët" nga pozita 101 kanë rënë në pozitën 102. Ndryshe, Kosova pati një ecuri të dobët gjatë vitit 2023 duke mos arritur rezultate pozitive në ndeshjet

kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2024". Në këtë ranglistë Kombëtarja Shqiptare ka rënë për dy pozita më poshtë krahasuar me ranglistën paraprake. Kuqezinjtë nga

pozita 62 kanë rënë në pozitën 64. Sa i përket kreut të renditjes, e para mbetet Argjentina, e ndjekur nga Franca dhe Anglia, kurse top pesëshja mbyllet me Belgjikën dhe Brazilin.



Elshani: Investova në futboll e nuk përfitova, mirëpres nismat për rithemelimin e KF Besa

PEJË, 15 SHKURT - Ish-kryetari i ish-KF Besa Pejë, Agim Elshani, në një intervistë për "KosovaPress", ka folur për sukseset në Klubin e Futbollit Besa në periudhën 2003-2007, kur u bë tri herë radhazi kampion. Derisa tregon për frymën e mirë që mbizotëroi në tërë klubin, Elshani flet me dhimbje për shuarjen dhe privatizimin e klubit.

Ish-kryetari Elshani thekson se në futboll ka dhënë kontributin e tij. "Unë në futboll nuk kam qenë për para, përkundrazi unë paratë i kam dhënë për futbollin", ka thënë fillimisht Elshani.

Klubi i Futbollit Besa nga Peja gjatë viteve 2003-2007 kishte marrë katër tituj, tre të kampionit të Kosovës si dhe një herë fitues i Kupës së Kosovës. E për çelësin e këtij suksesi tregon ish-prijësi i klubit. "Padyshim që suksesi i asaj kohe është më i madhi për KF Besa e cila tani nuk ekziston më. Çelësi ishte te fryma gjithëpërfshirëse që krijua rreth klubit. Ne të gjithë veteranët e futbollit, gjithë njerëzit që e donin futbollin i afroam dhe i mbajtëm afër me qëllim që klubin ta kthejmë në një klub kampion. Mendoj se një qytet e kishim afër

dhe pranë nesh. Kjo ishte thelbësorja, ndërsa arsye tjetër ishte puna profesionale që bënin në klub kur afroam profesionistët më të mirë që të merren me organizimin e klubit, ndërsa që talenti i asaj gjenerate të lojtarëve arriti të vinte në shprehje me organizim të mirë dhe financa të rregullta. Ne kishim ndihmuar futbollin që nga paslufta me themelimin e KF Shqiponja dhe sportin e kulturën e qytetit në përgjithësi, dhe kur na u ofrua mundësia edhe KF Besa që ishte klub i qytetit me të cilin njerëzit ishin të lidhur shumë", shprehet ai. Elshani konsideron se punët në KF Besa filluan të shkojnë keq që prej mungesës së tij dhe kolegëve të vet. "Konsideroj që punët rreth klubit të Besës në vitet më pas kur nuk isha unë dhe kolegët e mi, filluan të shkojnë keq. Unë asnjëherë nuk kam folur për këtë që mos të keqkuptohem se nuk kisha ambicie përderisa nuk isha në klub me deklarata ta prish atmosferën. Konsideroj që ishte gabim përjashtimi i njerëzve që ishin afër klubit e që kishin sjellë suksese. Hiq pjesën profesionale që janë marrë me organizim të



klubit, pjesa dërrmuese e njerëzve që ndikuan në sukseset e klubit ishin të angazhuar vullnetarisht pa asnjë kompensim apo benefit. Pas vitit 2007 në klub erdhën situata të tjera dhe njerëzit në krye të klubit jo që afronin, por largonin njerëz dhe, si rrjedhojë e kësaj situatë, nuk kanë mundur të kenë suksese. Ja një shembull po ju jap, personalisht që nga ajo kohë kur jam larguar nga klubi kurë më askush as për të parë një ndeshje nuk më ka ftuar", ka shtuar Elshani. E privatizimi i klubit, sipas Elshanit, është dëmi më i madh që mund t'i jetë bërë sportit pejan. "Së pari po dua të theksoj se unë në futboll nuk kam qenë për para, përkundrazi unë paratë i kam dhënë për

futbollin. Ky është dallimi i madh mes meje dhe të tjerëve. Unë s'kam qenë i interesuar as të privatizoj e as të jem i përhershëm në klub. Në një moment të caktuar kam pasur mundësi ta ndihmoj futbollin dhe e kam bërë këtë. Besoj në mënyrën më të mirë. Privatizimi i KF Besa është bërë po them në mënyrë të çuditshme, mos të them ndonjë fjalë tjetër. KF Besa ka qenë me vendim klub i qytetit si bashkim i tri klubeve të atëhershme: Budućnostit, Besës e Kristalit me një emër në kohën kur shqiptarët u larguan nga stadiumet në vitet '90. Si klub i tillë i qytetit, KF Besa ka funksionuar gjatë viteve '90, pastaj pas luftës edhe në kohën kur kam qenë në krye të klubit. Kush i jep të drejtë vetes të mbledhë një numër të caktuar të njerëzve për ta sjellë vendimin për privatizim nuk e di, por e di se ky proces nuk është dashur të shkojë kështu për një klub të tillë si KF Besa, e që kaloi brenda natës nga klub i qytetit në klub të disa individëve. Kjo gjithmonë do të mbetet enigmë dhe veprimi më i keq që i është bërë sportit pejan", vijon Elshani. Si rrjedhojë, pas privatizimit klubi shkoi drejt rënies deri në shuarje.

"Unë konsideroj që mënyra se si është bërë transformimi i klubit ka plot mjegull dhe kjo mjegull e ka përcjellë punën edhe pas privatizimit e dështimit deri në shuarje të klubit. Pse dhe si u lejua që të shkonte klubi përherë e më poshtë nuk mund ta kuptoj. Këtë do të duhej ta dinin ata që privatizuan klubin, ata që udhëhoqën klubin dhe organet komunale që e dërguan KF Besa në Brestovik të luante ndeshjet e jo në stadiumin e qytetit", thekson ai. Ish-kryetari i KF Besa flet edhe për nismën e re për rikthimin e klubit. "Unë për këtë nismë kam mësuar nga mediet, nuk jam thirrur fare për kesi lloj rithemelimi të klubit të qytetit, se klubi që ka pasur traditën, fatkeqësisht, nuk ekziston. Parimisht përkrah nisma të tilla që mund të jenë për të mirën e futbollit, por personalisht nuk jam ftuar e nuk jam pjesë e këtij zhvillimi", thotë ai derisa shton se nuk e pengon një gjë e tillë. "Unë nuk kam ambicie për të qenë protagonist në futboll. Unë e dua sportin dhe konkretisht futbollin dhe kurdo që mundem do ta ndihmoj", ka përfunduar Elshani.

Kosova U19 me sukses përmbylli kampin treditor në Hajvali

PRISHTINË, 15 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës U19 në konkurrencën e femrave e ka zhvilluar kampin seleksionues treditor. Në kampin Nacional në Hajvali u grumbulluan gjithsej 26 vajza, disa prej kampionatit vendor, por edhe futbolliste të tjera të cilat luajnë në klubet evropiane. Këto tri ditë i shërbyen përzgjedhësës Albina Rrahmani për t'i parë mundësitë dhe kapacitetin aktual të ekipit të Kosovës, i cili para kualifikimeve evropiane do të grumbullohet sërish për një fazë tjetër përgatitore. Rrahmani u shpreh e kënaqur me punën treditore në kamp, derisa

pohoi se duhet punë e përkushtim edhe më i madh drejt ndërtimit të një ekipi të denjë. "Ka qenë një test i mirë edhe për vajzat edhe për ne. Do t'i përcjellim vazhdimisht sepse e dimë që është fillimi i sezonit. Sikurse te secila gjeneratë, shihet se kemi shumë potencial, kemi futbolliste teknike, por ajo që na mungon pak është puna fizike, e që na mungon pothuajse në të gjitha gjeneratat. Megjithatë ishte kombinim shumë i mirë, me vajzat nga jashtë që kanë kualitet e fizik më të mirë, me vajzat vendore që kanë më shumë teknikë", u shpreh përzgjedhësja Rrahmani.



Edhe futbollistja Kreshnike Ramaja u shpreh e kënaqur gjatë periudhës së kaluar në këtë kamp. "Kemi kaluar shumë mirë, kemi pas futbolliste që kanë ardhur për herë të parë. Jemi munduar të

komponohemi edhe në lojë. Kampi ka shkuar mirë dhe besoj se kush e meriton do të udhëtojë për Gjibraltari për ndeshjet kualifikuese", ka deklaruar ajo. Sa i përket ndeshjes së sotme, ku përzgjedhësja ndau lojtaret e grumbulluara në dy ekipe, ajo ka thënë se loja ka qenë e mirë, por për shkak se ende nuk ka filluar stinori pranveror, nuk kanë qenë në gjendjen më të mirë fizike. "Ne ende jemi në fazë përgatitore me ekipe, prandaj e di se mundemi më mirë", ka shtuar ajo. Në anën tjetër Eliza Kadriu, e cila luan në ligën e Zvicrës, shprehu

dëshirën e madhe për të luajtur për Kosovën dhe pohoi se është mirëpritur nga ekipi kombëtar. "Kam shumë dëshirë të luaj për shtetin tim dhe kemi kaluar shumë mirë këtu. Luaj futboll tash e 10 vjet dhe kam shumë dëshirë të luaj. Jam e shpejtë, bëj lojë taktike dhe jam shumë e mirë", u shpreh futbollistja Kadriu. Përfaqësuesja e Kosovës U19 do t'i luajë ndeshjet e rrethit të dytë të kualifikimeve për Euro 2024 në Grupin 3 të Ligës B prej 2 deri më 8 prill në Gjibraltari. Krahas Kosovës dhe Gjibraltarit, në grup janë edhe Luksemburgu dhe Izraeli.

Eduard Shehu nënshkruan me Llapin

Podujevë, 15 shkurt - Llapi është përforcuar me futbollistin Eduard Shehu, i cili ka firmosur kontratë njëvjeçare me klubin që drejtohet nga Tahir Batatina. 23-

vjeçari vjen nga skuadra shqiptare, Besa Kavajë. "Sulmuesi i qendrës, Eduard Shehu, ka firmosur kontratë njëvjeçare me klubin me

mundësi vazhdimi. 23-vjeçari vjen nga skuadra shqiptare, Besa Kavajë. Shehu më parë ka qenë pjesë edhe e skuadrave si: EF Huesca U19 në Spanjë e Barnsley

U21 në Angli. Ai është shprehur i lumtur që ka nënshkruar me ne dhe pret që me besimin e shtabit teknik t'i tregojë cilësitë e tij", thuhet në njoftimin e Llapit.



Tare: Largimi im nga Lazio, sikurse Kloppi nga Liverpooli

Tiranë, 15 shkurt - Ish-drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare, flet për përfundimin e përvojës së tij me bardhekaltrit gjatë një interviste te Ran në Gjermani: "Kur u largova verën e kaluar, isha drejtori sportiv më jetëgjatë në Serinë A. Ne shkruam një histori të madhe. Disa suksese, dy herë fitimi i

Kupës së Italisë, tre herë i Superkupës dhe disa herë kualifikimi në Ligën e Kampionëve. Jam krenar për atë që kemi arritur vitet e fundit, sepse ende e mbaj mend saktësisht se në çfarë gjendje ishte Lazio kur fillova të punoja me ta". "Mosmarrëveshje me Lotiton?

Jo, nuk është e vërtetë. I thashë presidentit tim disa kohë më parë se do të ishte sezoni im i fundit sepse pas 15 vjetësh shumë intensive kishte ardhur koha që unë të bëja një pushim", ka thënë Tare. "Është e njëjta histori me Jurgen Kloppin me Liverpoolin. Dhe unë e çova Lazion në vendin e

dytë me një ekip të paprekur. Shumë lojtarë janë të njëjtë si vitin e kaluar, kështu që lidhja ime është ende shumë e fortë. Unë ende mbështes Lazion. Është e vërtetë që paraqitet në pjesën e parë të sezonit nuk ishin shumë të qëndrueshme, por në shtatë ndeshjet e fundit ka pasur pesë fitore dhe një



barazim dhe gjithçka është ende e hapur. Vetëm pesë pikë mungojnë nga vendi i katërt, që do të thotë Liga e Kampionëve", ka shtuar Tare.

Kuka: Trajnerët ta ulin egon e tyre, po e ngufatin sportin

PRISHTINË, 15 SHKURT - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka kërkuar nga institucionet sportive që të merren më shumë me përgatitjen e trajnerëve për sporte të ndryshme në mënyrë që e ardhmja e sportit të jetë më e mirë. Kuka mori pjesë në tryezën sportive që u organizua nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe nga Komiteti Olimpik i Kosovës, ku po punohet në Ligjin e ri të Sportit që pritet të votohet së shpejti në Kuvendin e Kosovës. Kuka ka thënë se çështjen e përgatitjes së trajnerëve e ka ngritur edhe gjatë bisedave me njohësit e fushës së sportit. "Kosova po ka suksese në grupmosha në 4-5 sporte, do të thotë po fitohen medalje evropiane dhe botërore, por me grupmosha jepen sinjalet të cilat mandej duhet ecur para me profesionalizëm deri në detajet më të vogla. Sfidat fillon aty ku talenti nuk mjafton, aty ku profesionalizmi i trajnerëve fillon dhe të tillë kemi pak, shumë pak", ka shkruar Kuka.



Më tutje, ai ka shtuar se disa trajnerë, duke mos e pranuar mosdijen e tyre, po e ngufasin sportin dhe talentët e tij. "Potencova edhe një problem që po i ngulfat talentët. Ego e trajnerëve për të mos pranuar realitetin (mosdijen). Me zëvendësimin Daulina Osmani u dakorduam që të

punohet në këtë drejtim. Besoj se do të kemi hapa konkretë në këtë drejtim, si të ndërtohen garuesit me potencial në garues kulminant. Federatat të kuptojnë që pa trajner elitare nuk ka rezultate elitare. Kosova ka potencial talentësh në shumë sporte, por që pak po e prekin kulminacionin", ka shtuar Kuka.

Fitojnë Bostoni, lakersat dhe clippersat, bien kampionët e Denverit



BOSTON, 15 SHKURT - Bostoni mbetet skuadra më e mirë në NBA, duke fituar me rezultat 136-86 ndaj Brooklynit, fitorja më e thellë e regjistruar këtë sezon (50 pikë diferencë). Pritchard me 28 pikë e White me 27 pikë ishin dy shënuesit më të mirë të Bostonit, që preku kuotën e 43 fitoreve në NBA këtë sezon. Fitorja e tretë radhazi për lakersat, që mundën me

rezultat 138-122 Utah Jazz jashtë fushës. Davisi me 37 pikë e Hachimura me 36 pikë bënë diferencën për ekipin kalifornian në këtë sfidë. Fitoi edhe ekipi i clippersave, që mundi me rezultat 130-125 Golden State, që ndalet pas pesë fitoresh radhazi. Për clippersat shkëlqeu Hardeni me 26 pikë. Humbet ekipi kampion i Denverit, që u mund me rezultat 102-98 në

fushën e tij nga Sacramento. De'Aron Fox me 30 pikë u dallua për miqtë. Jashtë fushe fiton edhe Miami, që mundi me rezultat 109-104 Philadelphia (Herro e Adebayo nga 23 pikë secili), ndërsa Memphis mundi me shifrat 121-113 Houstonin (Jackson 20 pikë).

REZULTATET

Charlotte - Atlanta	122-99
Orlando - New York	118-100
Philadelphia - Miami	104-109
Boston - Brooklyn	136-86
Cleveland - Chicago	108-105
Toronto - Indiana	125-127
Memphis - Houston	121-113
New Orleans - Washington	133-126
Dallas - San Antonio	116-93
Denver - Sacramento	98-102
Phoenix - Detroit	116-100
Utah Jazz - Lakers	122-138
Golden State - Clippers	125-130

Agentja e Pogbas: Ai po stërvitet për t'u rikthyer në fushë

Nga e premija e 16 shkurtit çdo moment mund të jetë i duhuri për dëgjimin e Paul Pogbas para Gjykatës Kombëtare Anti Doping. Avokatët e mesfushorit

francez kishin marrë shtyrjen nga 18 janari për ta përgatitur mbrojtjen pasi lojtari i Juventusit rezultoi pozitiv me "pentahydroepiandrosteron

e", i cili është një hormon pararendës i testosteronit. Agentja e tij Raëla Pimenta hodhi dritë mbi të në një intervistë me "Cronache di

Spogliatoio". "Pogba mund të kthehet të premten në fushë. Ai është gati për çdo situatë. Ai është, gjithashtu, një kampion mendërisht. Pogba merr

goditje, e tretë atë dhe vazhdon përpara. Ai stërvitet duke e ditur se duhet të jetë gati", ka deklaruar agentja e lojtarit francez.

SHKURT

Shtyhet rikthimi i Nadalit

Superylli i tenisit Rafael Nadal gjithashtu ka shtyrë rikthimin e tij të planifikuar në turneun në Doha. Spanjoli, i cili është i lënduar për një kohë të gjatë, ende nuk është gati për turneun e vështirë nga 19 deri më 24 shkurt në Katar, njoftoi ai në platformën X të mërkurën në mbrëmje. 37-vjeçarit kohët e fundit iu desh ta anulonte pjesëmarrjen e tij në Australian Open për shkak të një çarje të vogël në muskul. Ai më parë kishte qenë jashtë për një kohë të gjatë për shkak të një dëmtimi në ijë. Ai tani dëshiron të vazhdojë të punojë dhe po synon rikthimin për turneun Masters në Indian Wells në mars, siç njoftoi 22 herë fituesi i Grand Slamit. Pak kohë më parë Nadali kishte njoftuar tashmë se 2024 do të ishte ndoshta sezoni i tij i fundit.

Muller: Ende asgjë nuk ka përfunduar

Veterani i Bayern Munchenit, Thomas Muller, u shpreh se, pavarësisht prej humbjes 0-1 ndaj Lazio në ndeshjen e parë të 1/16-tës të Ligës së Kampionëve, asgjë nuk është e mbyllur për sa i përket kualifikimit. "Kemi ende edhe 90 minuta për të luajtur, ndaj jemi optimist. Luajmë në fushën tonë dhe pres që tifozët të na mbështesin. Pres një ndeshje shumë mbrojtëse nga Lazio pas dy javësh, një ekip që do t'i presë gabimet tona, ashtu si në ndeshjen e parë. Një stil mbrojtës shumë italian", ka thënë Mulleri. "Ndeshjet me Lazion janë të vështira, por mendoj se rezultati i sfidës së parë lë ende gjithçka të hapur. Kemi ekip të mirë, që i duhet edhe pak fat", u shpreh Mulleri.

Sarri: Në Bayern na pret ndeshje ferri

Lazio shënoi fitore në ndeshjen e parë të 1/16 së finales në Ligën e Kampionëve ndaj Bayern Munchenit (1-0), por trajneri Maurizio Sarri qëndron me këmbë në tokë. Ai ka thënë se asgjë nuk ka përfunduar, se e pret skuadrën e tij një ndeshje e fortë në Munchen. "Fituam kundër një prej skuadrave më të forta në Evropë, por jemi disi të dëshpëruar pasi mund të shënonim më shumë në fund. Më pëlqeu mënyra, kompaktësia dhe shpirti i ekipit, por jemi të vetëdijshëm se në Munchen na pret ferri", u shpreh Sarri.

Mourinho: Shkarkim i papritur dhe i padrejtë

Jose Mourinho e quajti shkarkimin e tij të fundit nga Roma "të papritur dhe të padrejtë" pasi sugjeroi se pronarët e klubit "dinë pak për futbollin". Trajneri portugez u shkarkua pas një humbjeje nga Milani (3-1). Mourinho fitoi Ligën e Konferencës në sezonin e tij të parë dhe e çoi Romën në finalen e Ligës së Evropës në vitin e dytë. Shkarkimi i tij nuk është pëlqyer veçanërisht nga mbështetësit e "Giallorossëve", të cilët i kanë bërë të qarta ndjenjat e tyre me pankarta dhe postera në të gjithë qytetin. "Grupet evropiane janë gati të fillojnë, në veçanti Liga e Kampionëve, ndoshta gara më e rëndësishme në kalendarin botëror", ka thënë fillimisht Mourinho. "Nuk do të jem aty në këto faza finale, jo sepse jam eliminuar tashmë, por sepse jam 'eliminuar' nga dikush që di pak për futbollin. Kjo është jeta, plot ulje-ngritje, dhe unë po rritem, pavarësisht prej shkarkimit të papritur dhe të padrejtë. Por unë do të kthehem, me më shumë entuziazëm dhe besim, për këto ndeshje të UEFA-s", ka shtuar portugezi.

Dje u bënë katër vjet pa më të dashurën tonë



Shefkije Preniqi Misini

(15.03.1945-15.02.2020)

Të rënda qenkan ditët kur mungon prania jote. Në këtë përvjetor qenka shumë vështirë të shkruajmë për ty, por megjithatë jemi krenare që patëm një nënë, gjyshe, motër, vjehërr siç ishe ti. Dashuria, mirësia dhe urtësia që kishe ndaj familjes dhe farefisit, na bën që mos të harrojmë kurrë.

Të jetosh në zemrat e atyre që lë pas, do të thotë të mos vdesësh kurrë.

Gjithmonë krenarë që të patëm dhe shumë të pikëlluar që të humbëm.

Edhe pse nuk je më fizikisht me ne, në zemrat tona do të jetosh gjithmonë.

Të kujtojnë me shumë mall: djemtë, vajzat, motra, rejat, nipat dhe mbesat.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejta

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besine Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit "Fehmi Agani".

- Xhynaze Cena shpall të pavlefshme dëftesat e kl BI - IX shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

- Njomza Jaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Hysni Zajmi".

- Halid Asllani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu "28 Nentori" Brodosan Dragash.

- Përparim Cakaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI-IX SH.F.M.U."Ibrahim Fehmiu" Prizren.

- Halid Asllani shpall të pavlefshme dëftesën e vitit I Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Osman Hodaj shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.e. "Ymer Prizreni" Prizren.

- Blerina Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë dhe të dytë të shkollës "Nexhmedin Nixha".

Ordinanca "ECHO-SOPI" shpall të pavlefshme certifikatën biznesit me nr. Unik Identifikues: 70391963.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Nuriye Fazliu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda" Mitrovicë.

- Art Muhaxhiri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të shkollës "Hajdar Dushi".

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Muhamer Bujari shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

